

**10 vjet**  
2017



Oda e arkitektëve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë (OAIA) bashkon të gjitha drejtimit e inxhinierëve në Republikën e Maqedonisë. Është i vetmi institucion i autorizuar që lëshon autorizime për inxhinierët dhe arkitektët e Republikës së Maqedonisë nga aspekti i tyre profesional dhe kompetent. OAIA lëshon edhe vërtetime për autorizimet e inxhinierëve dhe arkitektëve të huaj që punojnë në Republikën e Maqedonisë. Tani për tani, OAIA ka më shumë se 3 000 anëtarë aktiv dhe 4 000 anëtarë tjerë shtesë joaktiv.

Përveç aktiviteteve vendore, Oda është e anëtarësuar në Këshillin Evropian të Odës së Inxhinierëve (ECEC), në Federatën Botërore të Organizatave të Inxhinierëve (WFEO) dhe Iniciativën e Inxhinierëve për bashkëpunim regional (IIRS).

Si institucion profesional Oda ka rol aktiv në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të arkitektëve dhe inxhinierëve në Republikën e Maqedonisë, përmban një numër të simpoziumeve të inxhinierëve, kongreseve dhe ndodhive tjera të organizuara nga shoqatat e inxhinierëve në vend.

Oda ka 12 departamente profesionale për çdo drejtim të inxhinierëve. Kompetenca bazë e të gjitha departamenteve është lëshimi i autorizimeve inxhinierike për arkitektët dhe inxhinierët e Republikës së Maqedonisë, vërtetime për autorizimet e inxhinierëve të huaj, si dhe organizim të trajnimeve për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të Odës.

## UDHËHEQËSIA AKTUALE E ODËS:

### **Kryetari i Kuvendit të Odës:**

prof. d-r Mile Stankovski

### **Zëvendës kryetari i Kuvendit të Odës:**

m-r Bashkim Alili

### **Kryetari i Odës:**

prof. d-r Mile Dimitrovski

### **Nënkryetari i Odës:**

d-r Gajur Kadriu

### **Ish-kryetarët e Odës:**

m-r Bllashko Dimitrov, inxh. i dipl. i ndërtimtarisë  
(prej 2012 deri 2016)

d-r Strahinja Trpevski, inxh. i dipl. i arkitekturës  
(prej 2008 deri 2012)



## VIZIONI

Pozicionimi i Odës së arkitektëve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar si anëtare relevante dhe me të drejta të barabarta në asociacionin e inxhinierisë ndërkombëtare, pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e profesionit të inxhinierëve dhe përforcimin e rolit të inxhinierëve në shoqëri.

## MISIONI

Oda ta shfrytëzoj ndikimin dhe autoritetin e vet dhe në bashkëpunim me institucionet relevante të bëjë avancimin dhe përmirësimin e dispozitave të caktuara ligjore dhe akteve tjera nënligjore në interes të arkitektëve, inxhinierëve dhe të inxhinierisë në përgjithësi.

## VEPRIMTARITË

Aftësimi permanent i anëtarëve të vet nëpërmjet organizimit të trajnimeve. Lëshimi dhe vazhdimi i autorizimeve për inxhinier dhe arkitekt të vendit dhe të jashtëm.

Publikimi i revistës profesionale PRESING.

Nostrifikimi i projekteve të huaja.

Mbështetja e shoqatave profesionale të inxhinierëve në vend.

Organizimi i seminareve, konferencave dhe ngjarjeve tjera profesionale.

## KUSHTET PËR ANËTARËSIM NË ODË:

1. Nënshetësi të Republikës së Maqedonisë
2. Arsimit të lartë në profesionin e duhur (240-300 ECTS)
3. Përvojë pune pas diplomimit më së paku 3 vjet
4. Më së paku tre referenca për çdo autorizim që aplikoni

Linku: <https://www.komoraoui.mk/ovlastuvanja/izdavanje-na-novi-ovlastuvanja.html>

## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I URBANISTËVE DHE PLANIFIKUESVE HAPËSINORË

**I themeluar:** Në vitin 2012 (nga viti 2008 deri në vitin 2012 ka funksionuar në kuadër të Departamentit të arkitekturës).


**Numri i anëtarëve aktiv:** 218 (nga gjithsej 516 anëtarë)

### **Udhëheqës i Departamentit:**


m-r Zhaklina Angelovska, inxh. i dipl. i arkitekturës

**Për Departamentin:** Ndërtimi fillon me planin urbanistik tani më të miratuar ose dokumentacionin e planifikimit hapësinorë për të cilin është i nevojshëm të angazhohet urbanist, bartës i planifikimit hapësinor. Urbanisti fokusohet në nivelin makro të planifikimit hapësinor për dallim të inxhinierëve të drejtimeve të tjera të cilët fokusohen në mikro hapësirën për realizimin e objektit konkrete. Vetëm me qasje profesionale dhe shkencore mund të realizohet një jetesë njerëzore në zonë urbane.

**Vizioni:** Urbanizmi është hallkë e zinxhirit inxhinierik, i cili duhet të jetë lartësim i komunitetit inxhinierik dhe kohezion i ndërsjellët. Në departament të mbizotëroj profesionalizmi gjatë miratimit të planeve urbanistike dhe zhvillimit të jetesës humane.



## Analiza e autorizimeve:



## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I ARKITEKTËVE

**I themeluar:** Në vitin 2008

**Numri i anëtarëve aktiv:** 719 (nga gjithsej 1 783 anëtarë)


### Udhëheqës i Departamentit:

Rexhep Asani, inxh. i dipl. i arkitekturës

**Udhëheqësit e mëparshëm:** d-r Gajur Kadriu (2008-2012) dhe d-r Strahinja Trpevski (2012-2016)

**Për Departamentin:** Arkitekti është bartës i procesit të planifikimit, projektimit dhe realizimit të ndërtimit duke e pasur për synim të sjell vendime praktike, ekonomikisht të arsyetueshme dhe estetike. Misioni themelor i Departamentit të arkitektëve është të siguroj kushte për krijimin e arkitekturës kualitative, duke ruajtur reputacionin e profesionit si dhe të drejtat e arkitektit të autorizuar si projektues, mbikëqyrës, revident dhe realizues të ndërtimit, duke mos i penguar interesat e personave të tjerë që janë pjesë e këtij procesi.

**Vizioni:** Duke e pasur para vetes vizionin themelor për të siguruar përmirësim të besueshëm dhe të matshëm të veprimtarisë arkitektonike, objektivat e departamentit janë të drejtuara në planifikim të aktiviteteve të cilat do të sigurojnë arkitekt profesional dhe të motivuar të cilët do të jenë të gatshëm që të ofrojnë shërbime më të mira dhe do të krijojnë arkitekturë në pajtueshmëri me mjedisin.



## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I INXHINIERËVE TË NDËRTIMTARISË

**I themeluar:** Në vitin 2008

**Numri i anëtarëve aktiv:** 1 073 (nga gjithsej 2 406 anëtarë)


**Udhëheqës i Departamentit:** prof. d-r Petar Cvetanovski, inxh. i dipl. i ndërtimtarisë

**Udhëheqësit e mëparshëm:** prof. d-r Sande Atanasovski (2008-2012) dhe Salim Hasani (2012-2016)

**Për Departamentin:** Departamenti i inxhinierëve të ndërtimtarisë numëron më shumë se 1 000 anëtarë aktiv. Organizon seminare të shumta me tema aktuale, prezantime të teknologjive të reja në projektim dhe realizim, tryeza të rrumbullakëta për tema profesionale dhe vendime për legjislacionin aktual. Së bashku me Fakultetin e ndërtimtarisë kishte aktivitete gjatë revizionit profesional të përkthimeve të rregullores evropiane për konstruksionet e ndërtimit – Eurokodet dhe gjatë organizimit të seminareve për implementimin e tyre.

**Vizioni:** Njëri nga qëllimet kryesore të Departamentit është afirmimi dhe përparimi i inxhinierisë së ndërtimtarisë dhe rritja e numrit të anëtarëve aktiv. Qëllimi mund të realizohet përmes një Ode të fortë dhe të integruar. Departamenti do të fokusohet në miratimin e çmimores për shërbimet inxhinierike. Shumë vendime në Ligjin për ndërtim janë në konflikt me praktikën teknike dhe me interesat e inxhinierëve të ndërtimtarisë dhe Departamenti do të angazhohet për ndryshimin dhe plotësimin e tyre me çka do të tejkalohet një varg i palogjikshëm. Për shembull, kategorizimi i objekteve dhe kriteret për marrjen e autorizimeve.

**Analiza e autorizimeve:**



## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I ELEKTROINXHINIERËVE

**I themeluar:** Në vitin 2008

### **Numri i anëtarëve aktiv:**

502 (nga gjithsej 1 196 anëtarë)


### **Udhëheqës i Departamentit:**

Vlatko Todorovski,  
inxh. i dipl. i elektroteknikës

### **Udhëheqësit e mëparshëm:**

prof. d-r Mile Stankovski (2008-2016)


### **Analiza e autorizimeve:**



- Proektim A
- Proektim B
- Mbikëqyrje A
- Mbikëqyrje B
- Realizim A
- Realizim B
- Revizion A
- Revizion B

**Për Departamentin:** Oda i artikulon, nxit, vlerëson dhe i nxjerr në pah profesionet dhe karakteristikat individuale të anëtarëve. Kjo qasje nënkupton monitorim të vazhdueshëm të punës së anëtarëve të Departamentit dhe kryen informim dhe udhëzim për arsimim plotësues individual apo të organizuar. Ky zgjerim i njohurive të elektroinxhinierëve bëhet në elektroteknik dhe në fushën e materialeve të ndërtimit dhe procedurave të ndërtimit, materialet e reja teknologjike dhe produkteve në elektroteknik, inovacionet në inxhinierinë mekanike, termoteknike, hidroteknike dhe inkuorporimin e arritjeve në teknologjinë informatike.

**Vizioni:** Vizioni për punë është i bazuar në zgjerimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit mes inxhinierëve të Departamentit, që dukshëm ndikon në tërësinë e kërkesave dhe prioriteteve. Prioritet është ndërtimi i kritereve të reja për kategorizimin e objekteve nën kushte të përpikta dhe kritere vendimtare të ndërtimit dhe kritere për dhënien e autorizimeve për projektim, revizion, mbikëqyrje dhe realizim.



## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I INXHINIERËVE TË MAKINERISË

**I themeluar:** Në vitin 2008

**Numri i anëtarëve aktiv:**

548 (nga gjithsej 1 040 anëtarë)

**Udhëheqës i departamentit:**

Dimçe Gallovski, inxh. i dipl. i makinerisë


**Udhëheqësit e mëparshëm:**

d-r Bekim Fetaji (2008-2012)

prof. dr. Mile Dimitrovski (2012-2016)

**Për Departamentin:** Në Departament janë të anëtarësuar inxhinier nga fusha e inxhinierisë mekanike.


**Analiza e autorizimeve:**



- Proektim A
- Proektim B
- Mbikëqyrje A
- Mbikëqyrje B
- Realizim A
- Realizim B
- Revizion A
- Revizion B

Inxhinierët më të vjetër me shkallë të arsimimit VII/1 më së shpeshti janë nga drejtimi energjetik, ndërsa inxhinierët që janë me arsimim të Bolonjës, shumica janë nga drejtimet e inxhinierisë termike, hidroteknike, pneumatik dhe automatizëm, saldim, konstruksione të salduara dhe sistemet transportuese dhe liftet. Të gjitha këto drejtime kanë veprimtari të lidhur me Ligjin për ndërtim. Në periudhën e mëparshme Departamenti është marr me dhënien e autorizimeve dhe një numër i madh i të interesuarve të cilët veprimtarinë e tyre e lidhin me Ligjin për ndërtim kanë marrë autorizime.

Departamenti, nëpërmjet Odës, mundëson që të ketë ndikim në konceptin edukativ të institucioneve të arsimit të lartë, për të fituar njohuri bashkëkohore inxhinierët, a këtë e bën me rekomandimet e Departamentit të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e planeve mësimore të Fakulteteve që edukojnë inxhinier të drejtimit të makinerisë.



## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I INXHINIERËVE TË KOMUNIKACIONIT

**I themeluar:** Në vitin 2008

**Numri i anëtarëve aktiv:**

43 (nga gjithsej 120 anëtarë)

**Udhëheqës i Departamentit:**

Jovan Hristovski, inxh. i dipl. i komunikacionit

**Udhëheqësit e mëparshëm:**


m-r Slobodan Dimitrovski (2008-2011)

**Për Departamentin:** Në thelb themelimi i departamentit daton dhe rrjedh nga Ligji për ndërtim, kur me vendim përcaktohet pozicioni i duhur i inxhinierëve të komunikacionit dhe ata fitojnë status të barabartë. Themelimi i këtij Departamenti sjell rritje të numrit të inxhinierëve të komunikacionit të cilët merren me projektim, revizion, mbikëqyrje dhe realizim. Karakteristike për profesionin është që të mund të punoj në projektim, inxhinieri duhet të fitoj njohuri shtesë, gjë e cila është në rritje për shkak të zhvillimit ekonomik të shtetit, ndërtimit të rrugëve dhe objekteve.



Për këtë shkak paraqitet mungesë e projektuesve në fushën e inxhinierisë së komunikacionit.

**Vizioni:** Përmes organizimit të seminareve, trajnimeve, punëtorive dhe ligjëratave profesionale në kuadër të Odës t'i çojmë përpara dituritë dhe shkathhtësitë e anëtarëve tonë. Me promovimin e punës së Odës dhe Departamentit të bëjmë të mundur rritjen e numrit të anëtarëve të rij.



## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I INXHINIERËVE TË GJEOLOGJISË DHE GJEOTEKNIKËS


**I themeluar:** Në vitin 2008

**Numri i anëtarëve aktiv:**  
44 (nga gjithsej 112 anëtarë)

**Udhëheqës i Departamentit:**  
prof. d-r Spasen Gjorgjevski,  
inxh. i dipl. i ndërtimtarisë

**Udhëheqësit e mëparshëm:**  
prof. d-r Milorad Jovanovski,  
inxh. i dipl. gjeolog (2008-2016)

**Për Departamentin:** Departamenti i gjeoteknikës kujdeset për të drejtat e inxhinierëve nga fusha e gjeoteknikës dhe nga shkencat teknike të lidhura me të për të vepruar në mënyrë proaktive dhe profesionale në fushën e gjeoteknikës. Për t'i arritur qëllimet, Departamenti e koordinon dhe stimulon ndjekjen e zhvillimit bashkëkohor të shkencës dhe praktikës, mundëson informim në kohë të anëtarëve të saj, e stimulon dhe përforcon shkëmbimin e ideve dhe transferimin e njohurive dhe informacioneve si dhe organizon forma



të ndryshme të takimeve profesionale dhe prezantimeve, ekspozita, seminare, simpoziume dhe të ngjashme. I stimulon dhe përmban iniciativat e anëtarëve të saj për hulumtime shkencore, si dhe zbatimin e rezultateve hulumtuese-shkencore në fushën e gjeoteknikës; bashkëpunon me asociacione ndërkombëtare dhe të vendit; organizon dhe boton publikime shkencore dhe profesionale për nevojat e anëtarëve të saj dhe kujdeset për stërvitjen profesionale dhe përtëritjen e njohurive të anëtarëve.

## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I INXHINIERËVE PËR AMBIENT JETËSOR


**I themeluar:** Në vitin 2008

**Numri i anëtarëve aktiv:**  
27 (nga gjithsej 83 anëtarë)

**Udhëheqës i Departamentit:**  
prof. d-r Hristina Spasevska,  
inxh. i dipl. i fizikës

**Udhëheqësit e mëparshëm:**  
prof. d-r Murtezan Ismaili,  
prof. d-r Bekim Fetaji

**Për Departamentin:** Departamenti i ambientit jetësor është aktiv që nga themelimi i Odës, kur janë dhënë edhe autorizimet e para rreth njëzet ekspertëve të cilët kanë angazhim profesional në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor. Sot ky departament përfshin inxhinier të ambientit jetësor, por edhe inxhinier nga disiplina të ndryshme që kanë realizuar projekte nga kjo fushë. Pjesë e anëtarëve janë bartës të autorizimeve nga departamentet tjera të Odës, që tematikisht dhe organizativisht e bën multidisciplinuar këtë departament.



**Vizioni:** Departamenti, sipas ekspertizës multidisciplinare të anëtarëve, duhet të paraqet ind lidhës ndërmjet departamenteve me qëllim të punimit të projekteve kualitative. Kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtje të ambientit jetësor dhe ndërtime ekologjike i detyrojnë anëtarët e departamentit të punojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes në këtë fushë nëpërmjet pjesëmarrjes në përgatitjen e projekteve.

## DEPARTAMENTI PROFESIONAL I INXHINIERËVE TË GJEODEZISË

**I themeluar:** Në vitin 2010


**Numri i anëtarëve aktiv:**  
57 (nga gjithsej 113 anëtarë)

**Udhëheqës i Departamentit:**  
prof. d-r Jovan Jovanov,  
inxh. i dipl. i gjeodezisë

**Udhëheqësit e mëparshëm:**  
prof. d-r Vanço Gjorgjiev,  
inxh. i dipl. i gjeodezisë (2010-2016)

**Për Departamentin:** Departamenti i gjeodezisë kujdeset për të drejtat e inxhinierëve nga fusha e gjeodezisë dhe profesionet teknike të lidhura me të për të vepruar në punë dhe profesionalisht fushën e gjeodezisë. Për t'i arritur qëllimet, departamenti, koordinon dhe nxit ndjekjen e zhvillimit bashkëkohorë të shkencës dhe praktikës, mundëson informimin në kohë të anëtarëve të saj, e nxit dhe përforcon shkëmbimin e ideve dhe shpërndarjen e njohurive dhe informacioneve dhe organizon forma të ndryshme të takimeve profesionale dhe prezantimeve, ekspozita, seminare, simpoziume dhe të ngjashme.

I stimulon dhe përmban iniciativat e anëtarëve të saj për hulumtime shkencore, si dhe zbatimin e rezultateve hulumtuese-shkencore në fushën e gjeoteknikës; bashkëpunon me asocione ndërkombëtare dhe të vendit; organizon dhe boton publikime shkencore dhe profesionale për nevojat e anëtarëve të saj dhe kujdeset për stërvitjen profesionale dhe përtëritjen e njohurive të anëtarëve.



## DEPARTAMENTI I INXHINIERËVE TË MBROJTJES GJATË PUNËS DHE MBROJTJES KUNDËR ZJARRIT

**I themeluar:** Në Nëntor të vitit 2011

**Numri i anëtarëve aktiv:**  
16 (nga gjithsej 32 anëtarë)

**Udhëheqës i Departamentit:**  
prof. d-r Vanço Donev,  
inxh. i dipl. i makinerisë

**Për Departamentin:** Planifikimi i sigurisë dhe shëndetit gjatë punës duhet që të shihet si planifikim në fazën e zgjedhjes ideore, gjatë përgatitjes së dokumentacionit teknik, gjatë ndërtimit të objekteve, gjatë punës normale dhe planifikimit të situatave të

jashtëzakonshme. Ligji për ndërtim është i qart dhe rigoroz: secili inxhinier i përfshirë në ndërtim patjetër duhet të ketë autorizim të dhënë nga Oda; e definojnë fushën e punimit të dokumentacionit projektues, revizionit të projekteve, mbikëqyrjes gjatë realizimit të projekteve dhe realizimit në bazë të dokumentacionit projektues dhe ka të bëjë vetëm me inxhinierët të kyçur në këto projekte. Autorizimet nga mbrojtja gjatë punës dhe mbrojtja kundër zjarrit nuk janë të përshtatshme dhe nuk mund të shfrytëzohen për t'i zëvendësuar vërtetimet për dhënie e provimit për ekspert të sigurisë gjatë punës. Gjithashtu, ky vërtetim nuk është i përshtatshëm dhe nuk mund të shfrytëzohet si zëvendësim për cilindo autorizim të marrë në bazë të ligjit për ndërtim.



## DEPARTAMENTI PROFESIONAL PËR TEKNOLOGJI DHE METALURGI

**I themeluar:** Në vitit 2010

**Numri i anëtarëve aktiv:**  
5 (nga gjithsej 20 anëtarë)

**Udhëheqës i Departamentit:**  
prof. d-r Aleksandar Dimitrov,  
inxh. i dipl. i teknologjisë

**Për Departamentin:** Departamenti Teknologji Metalurgji i mbulon fushat teknologjike ku mësohen teknologjitë e prodhimit. Për më tepër, gjithçka që shohim rreth nesh dhe gjithë ajo të cilës i kemi caktuar çfarë do qoftë aplikimi në jetën moderne, është e punuar nga materialet. Gjithashtu, inxhinierët e teknologjisë i mbulojnë edhe teknologjitë

për prodhimin e ushqimit dhe produkteve bioteknologjike.

Prandaj, këto inxhinier kanë një rëndësi të madhe gjatë zhvillimit të teknologjive, projektimit dhe realizimit të objekteve industriale. Inxhinierët e këtij profili, me autorizime, janë të patjetërsueshëm për shtetin. Të gjithë së bashku duhet të mundohemi që numri i tyre të jetë sa më i madh.

**Vizioni:** Inxhinierët e teknologjisë dhe metalurgjisë janë ato që i krijojnë dhe menaxhojnë teknologjitë për prodhimin e materialeve organike dhe joorganike, ushqimit, metaleve dhe të tjera. Prandaj, ato paraqesin forcë lëvizëse të nevojshme për zhvillimin e çdo vendi, si në aspektin industrial dhe ekonomik, ashtu edhe në pikëpamje sociale.

## DEPARTAMENTI PROFESIONAL PËR EFIKASITET ENERGJETIK

**I themeluar:** Në vitit 2014

**Numri i anëtarëve aktiv:** 120

**Udhëheqës i Departamentit:**  
prof. i çrregullt d-r Dame Dimitrovski,  
inxh. i dipl. i makinerisë

**Për Departamentin:** Departamenti për Efikasitet Energjetik përfshin 4 profesione: arkitektët, inxhinierët e ndërtimtarisë, inxhinierët e makinerisë dhe inxhinierët e eketroteknikës. Departamenti ka organizuar disa trajnime për inxhinierët lidhur me përdorimin e materialeve të izolimit termik dhe sigurinë kundër zjarrit të objekteve dhe parametrave akustik të objekteve, përdorimin e sistemeve efikase për instalimet termoteknike... Inxhinierët e këtij departamenti janë përgjegjës për dokumentacionin e projektit të përcaktuar si: Elaborat për efikasitet energjetik apo dokumente të ngjashme që i kërkon investitori; Elaborat për fizikën e ndërtimit, Elaborat për termik dhe akustik, Elaborat për konsumin e energjisë në objekt dhe të ngjashme.



**Vizioni:** Ndërtimi i objekteve me efikasitet të lartë, me izolim të mirë termik dhe akustik, sisteme efikase për ajër të kondicionuar, pajisje efikase në objekte dhe komandimin e tyre, duhet të jenë përparësi jo vetëm për shkak të faturave të ulëta të shfrytëzuesit të objektit, por edhe një nga zgjedhjet për zvogëlimin e nevojave të përgjithshme të energjisë, a me atë edhe një parakusht kryesor për reduktimin e ndotjes dhe emetimin e gazrave serë.

## KOMISIONI PËR AUTORIZIME TË HUAJA

**I themeluar:** Në Nëntor të vitit 2012

**Numri i anëtarëve aktiv që kanë vërtetuar autorizimet e huaja:**

87 (nga gjithsej 408 anëtarë)

**Udhëheqës i Departamentit:**

Kryetari i Odës

Oda e arkitektëve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar, sipas nenit 42 të Ligjit për ndërtim, ka të drejtë ligjore që të jep dhe vazhdojë autorizimet e personave fizik nga shtetet tjera, për shkak se personi fizik i huaj me autorizim nga shteti tjetër mund të kryej punë në projektim, revizion, realizim dhe mbikëqyrje të ndërtimeve në Maqedoni vetëm në qoftë se autorizimi është i vërtetuar nga Oda.


Gjithashtu, Oda jep dokument për vërtetimin e autorizimit në qoftë se personi fizik i vendit apo i huaj është i zgjedhur në procedurën për furnizime publike për kryerjen e këtyre punëve në projekte të financuara nga organizatat ndërkombëtare dhe Unionit Evropian.

Autorizimi do të vlej vetëm për atë projekt.


Ekziston mundësia për personin fizik dhe/ose juridik i huaj të kryej projektim, revizion, realizim dhe mbikëqyrje sipas ligjit në qoftë se është arritur një kontratë ndërkombëtare për reciprocitet sipas kushteve të caktuara nga kontrata. Vërtetimin e autorizimeve e bën komisioni i themeluar nga kryetari i Odës.




## STATISTIKAT



Numri i anëtarëve aktiv 2012-2016



Ndjekja e seminarëve të organizuara nga Oda, 2012-2016



Anëtarët aktiv të departamenteve deri më datë 31.12.2016



## KODEKSI I ETIKËS PROFESIONALE

Anëtari i Odës është i obliguar detyrat e tij t'i kryej me përgjegjësi, përkushtim të plotë, njohuri dhe përvojë duke e mbështetur reputacionin e Odës.

Anëtari i Odës, në krahasim me arkitektët dhe inxhinierët e tjerë, duhet të sillet kolegjisht dhe të jetë lojal, si dhe t'ju ndihmoj dhe t'i këshilloj kolegët me këshilla të cilat bazohen në profesionalizëm dhe kompetencë.

Anëtari i Odës me reputacionin e tij profesional duhet që t'i ndërtoj edhe vlerat e reputacionit të tij personal.

Anëtari i Odës me punën e tij patjetër që t'i merr parasysh nevojat jetësore të njerëzve dhe shoqërisë.

Anëtari i Odës duhet që të mbështet sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien në shoqëri.

Anëtari i Odës duhet të veproj si një ndërmjetësues i besueshëm për punëdhënësit e tij apo klientët dhe t'i largohet konfliktit të interesave.

Anëtari i Odës duhet të ofroj shërbime profesionale në pajtueshmëri me autorizimin për fushën në të cilën e ka marr.

Anëtari i Odës mund të shpall publikisht vetëm deklarata objektive dhe të vërteta të cilat kanë të bëjnë me profesionin.

Anëtari i Odës nuk duhet që ta keqpërdor lidhjen me nëpunësit shtetëror dhe autoritetet përgjegjëse në qeveri e cila i nxjerr aktet e nevojshme për ndërtim.

Anëtari i Odës nuk guxon që në mënyrë direkte dhe indirekte tu bëj dëm kolegëve dhe duhet të përpiqet të jetë objektiv gjatë vlerësimit të punës së tyre...

*\*Tekstin e përgjithshëm të Kodeksit të etikës profesionale mund ta gjeni në ueb faqen oficiale të Odës së arkitektëve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë.  
(<https://www.komoraoai.mk/>)*



## Botues:

Oda e  
arkitektëve të autorizuar  
dhe inxhinierëve të autorizuar  
të Republikës së Maqedonisë  
Bul. Partizanski Odredi nr.29  
Qendra Tregtare Bunjakovec, lokali 15,(kati i dytë)  
1000 Shkup  
Tel: +389 2 3222 356  
[www.komoraoai.mk](http://www.komoraoai.mk)  
[contact@komoraoai.mk](mailto:contact@komoraoai.mk)

Shkup, 2017

Biblioteka kombëtare dhe universitare  
“Shën Klimet Orhidski” – Shkup



Për botuesin: prof. dr. Mile Dimitrovski  
Redaktimi grafik dhe artistik: MOVEdesing  
Fotografi: Angel Sitnovski

